



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## RAPORT

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

**Ex officio nr. 227/2019**

Drejtuar : Z. Glauk Konjufca, Kryetar  
Kuvendi i Kosovës

Z. Albin Kurti, kryeministër  
Qeveria e Republikës së Kosovës

Kopje: Z. Slavisha Mladenović, komisioner për Gjuhë  
Zyra e Kryeministrit

Z. Habit Hajredini, drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë  
Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 14 dhjetor 2023

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, vendosi t'i fillonte hetime sipas detyrës zyrtare lidhur me cilësinë e përkthimit të akteve juridike dhe mospërputhjen e tyre gjuhësore, veçanërisht në gjuhën serbe. Për këtë morëm shkas për faktin se gjatë punës sonë të përditshme kemi hasur në versione gjuhësore joidentike, relativisht në një numër të madh aktesh ligjore e nënligjore, madje edhe të vet Kushtetutës në versionet zyrtare të gjuhëve - shqip e serbisht.

Duke e monitoruar çështjen në shqyrtim, Avokati i Popullit synon t'ia tërheqë vëmendjen autoriteteve për ndikimin e kësaj situate në përmbushjen e standardeve kyçe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me të cilat garantohen të drejtat gjuhësore, që janë pjesë e Kushtetutës së Kosovës, Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Avokati i Popullit vëren se një sërë aktesh juridike përmbajnë dallime ndërmjet versioneve në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Këto dallime përfshijnë gabimet përmbajtjesore, terminologjike, gramatikore, drejtshkrimore dhe tipografike, të cilat përfshijnë përkthimin plotësisht ose pjesërisht të papërshtatshëm të fjalëve nga shqipja në serbisht, mospërfshirjen e pjesëve të përkthimit, si dhe shtimin e pjesëve të fjalive që nuk ekzistojnë në tekstin origjinal.

Si shembull mund të përmendim Kushtetutën. Në gjuhën serbe ka dallim thelbësor në nenin 134, paragrafi 1, i cili i referohet zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Në versionin në gjuhën shqipe thuhet: *"Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij."* Ndërsa në versionin në gjuhën serbe: *"Avokatin e Popullit e zgjedhë Kuvendi i Kosovës me shumicën e dy të tretave 2/3 të votave të të gjithë deputetëve."* Një ndryshim i tillë drastik jep hapësirë për një sërë konfliktesh të mundshme në kontekstin e zgjedhjeve demokratike.

Dallimi thelbësor është vërejtur edhe në Ligjin nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Nenet 11 dhe 12 të këtij ligji janë krejtësisht të ndryshme në gjuhën shqipe dhe në atë serbe. Neni 11 në gjuhën shqipe parashikon kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit dhe dallon dukshëm nga versioni serbisht, i cili në nenin 11, paragrafi 2, parashikon detyrimin për të punësuar persona me aftësi të kufizuar për çdo 50 punëtorë, ku versioni i ligjit në gjuhën shqipe flet për nenin 12, i cili në gjuhën shqipe parashikon detyrimin për të punësuar persona me aftësi të kufizuar për çdo 50 punëtorë, kurse neni 12 në gjuhën serbe të njëjtin detyrim e parashikon për 25 punëtorë dhe si i tillë është në kundërshtim me nenin 11 të ligjit në gjuhën serbe, gjë që krijon një konfuzion të plotë në dispozitat parësore të këtij ligji.

Dallime janë vërejtur edhe në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 53, paragrafi 1, në versionin në gjuhën shqipe parasheh: *"Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve."* Nga ana tjetër versioni në gjuhën serbe nuk parasheh rregullin e shumicës së thjeshtë, por përshkruan një strukturë ndryshe, në të cilën thuhet: *"Anëtarët e komisionit për komunitete do të jenë anëtarët e këshillit të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve"*. (*Članstvo u komisiji za zajednice će imati odbornici Skupštine opštine i predstavnici zajednica*).

Neni 61 i Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, paragrafët 1 dhe 3, në gjuhën serbe i referohen gabimisht “nënkryetarit për komunitete” si “predsedavajućeg za zajednice” (paragrafi 1), që do të thotë “kryesuesi për komunitete”; dhe “gradonačelnika za zajednice” (paragrafi 4), që do të thotë “kryetari i komunës për komunitete”.

Po ashtu dallime janë vërejtur edhe në Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, në nenin 4, paragrafët 1 dhe 3, për të cilin Avokati i Popullit ka rekomanduar për harmonizim gjuhësor.<sup>1</sup> MAPL-ja ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (MPL) nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, me të cilin është shfuqizuar Udhëzimi Administrativ MAPL nr. 2014/01, por çështja e harmonizimit gjuhësor nuk është rregulluar dhe në udhëzimin e ri bartet tek neni 5 [Nënkyetari i komunës për komunitete], paragrafi 2, i cili në gjuhën serbe “komuniteteve” joshumicë u referohet si “komuniteti” joshumicë, e që në praktikë mund të paraqesë problem në zbatim.

Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e definojnë që gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Më tej Kushtetuta e përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se kushdo e ka të drejtën e mbrojtjes së barabartë juridike, pa diskriminim, ndër të tjerash, në bazë të gjuhës. Në situata të tilla kur versionet e gjuhëve në akte normative nuk janë identike, mund të shpijë në situata ku interpretimi bëhet kompleks, subjektiv dhe shpie pashmangshëm në trajtim të pabarabartë.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14 e përcakton se gëzimi i të drejtave nga Konventa realizohet pa diskriminim, ndërsa neni 1 i Protokollit 12 të Konventës shprehimisht shprehet se çdo e drejtë e parashikuar nga ligji do të ushtrohet pa diskriminim në cilëndo bazë, që midis të tjerash e nënkupton edhe në bazë të gjuhës.

Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve e definojnë një status të barabartë të gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë. Neni 5, paragrafi 4, i Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve e definojnë se të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës do të nxirren dhe do të publikohen në gjuhët zyrtare dhe se versionet në gjuhët zyrtare janë të barasvlershme. Ligji më tej në të njëjtin nen e definojnë se të gjitha ligjet do të publikohen edhe në gjuhën boshnjake dhe në atë turke. Me këtë institucionet e Kosovës e zbatojnë një sistem ligjor shumëgjuhësh, në të cilin të drejtat e gjithëpërfshirjes gjuhësore të komuniteteve të ndryshme mbrohen me kornizën legjislative dhe me instrumentet ndërkombëtare.

Në përputhje me atë që u tha më sipër, Avokati i Popullit thekson se legjislacioni është instrumenti kryesor, me të cilin institucionet publike i rregullojnë të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë sjelljen e individëve, duke krijuar të drejta dhe detyrime, gjë që kërkon që rregulloret ligjore të jenë të qasshme, të sakta dhe të parashikueshme. Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aktgjykimin për rastin *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar* në paragrafin 49 thekson: “Së pari, ligji duhet të jetë i qasshëm në mënyrë adekuate: qytetarit duhet t’i mundësohet të ketë një tregues që është adekuat në rrethanat e rregullave ligjore që zbatohen në rastin e caktuar. Së dyti, një normë nuk mund të konsiderohet “ligj” nëse nuk është formuluar me saktësi të mjaftueshme që t’ia mundësojë qytetarit ta rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje - nëse është e nevojshme me këshillat e duhura - të parashikojë,

---

<sup>1</sup> Raport me Rekomandime: Ankesa nr. 9/2019 *Cengiz Kovaç kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal*.

*deri në një shkallë që është e arsyeshme në rrethanat, pasojat që mund të shkaktojë veprimi i caktuar.”*

Kjo do të thotë se rregulloret duhet të jenë të qasshme për publikun dhe të publikohen në mënyrë të përcaktuar dhe të rregulluar me ligj. Kjo siguron që të gjithë qytetarët ta kenë mundësinë të informohen për ligjin dhe ta kuptojnë se çfarë kërkohet prej tyre për ta respektuar atë. Saktësia nënkupton që ligji duhet të jetë i qartë dhe konkret në terminologjinë e tij, në mënyrë që qytetarët të mund ta rregullojnë sjelljen e tyre në mënyrë të rregullt. Parashikueshmëria nënkupton që ligji duhet të zbatohet në mënyrë konsekuente dhe të drejtë, në mënyrë që individët të kenë besim në sistemin ligjor dhe të jenë të sigurt se do të trajtohen në mënyrë të drejtë. E gjithë kjo është veçanërisht e rëndësishme në një sistem ligjesh shumëgjuhësh, ku ekziston rreziku që individët që nuk e flasin gjuhën dominuese mund të jenë në disavantazh.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se disa nga pasojat e mundshme që duhet të merren parasysh janë keqinterpretimi, pasiguria ligjore, kontestet juridike dhe qasja në drejtësi. Nëse versionet e ndryshme gjuhësore të të njëjtit ligj kanë formulime të ndryshme, kjo mund të çojë në konfuzion ose keqinterpretim të ligjit nga ana e individit. Nëse versionet e ndryshme gjuhësore të të njëjtit ligj kanë dispozita me përmbajtje të ndryshme, kjo mund të ndikojë në sigurinë juridike të individëve dhe në sundimin e ligjit.

Në kontekst të realizimit të shtetit të së drejtës, Komisioni Evropian vëren se aktet juridike duhet të prodhojnë të njëjtin efekt juridik, prandaj thekson se çdo ligj, pasi të interpretohet, duhet të përçojë të njëjtin kuptim absolut, në mënyrë që të prodhojë efekte të njëjta, pavarësisht prejardhjes gjuhësore të personit që është atakuar nga i njëjti.<sup>2</sup> Prandaj është e nevojshme që gjatë procesit të hartimit të ligjeve të ndërmerren masa për harmonizimin e akteve ligjore dhe sigurimin e besueshmërisë së legjislacionit shumëgjuhësh përpara publikimit të tyre në Gazetën Zyrtare.

Si hap pozitiv në drejtim të zgjidhjes së problemit të konstatuar, Avokati i Popullit thekson se Qeveria e ka miratuar Projektligjin nr. 06/L-030 për Aktet Juridike,<sup>3</sup> i cili është pranuar në Kuvendin e Kosovës dhe është shqyrtuar në parim nga ana e komisionit funksional të Kuvendit, por i njëjti ende është në procedurë për shqyrtim në seancë. Rëndësia e miratimit të këtij ligji në kontekstin e çështjes në shqyrtim reflektohet në faktin se përveç përcaktimit të llojeve dhe hierarkisë së akteve juridike, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përcakton edhe parimet dhe standardet për hartimin, nxjerrjen, miratimin, konsolidimin, botimin dhe zbatimin e akteve ligjore, i njëjti po ashtu parashikon dhe definon edhe korigjimin<sup>4</sup> e akteve ligjore, si dhe mënyrën se si kryhet korigjimi i akteve juridike në rast të identifikimit të akteve gjuhësore, gabimeve drejtshkrimore, llogaritëse, teknike, pasaktësive të tjera të ngjashme, të dukshme, ose në rast të mospërputhjes ndërmjet gjuhëve zyrtare në aktin juridik.<sup>5</sup> Kjo do të thotë se Projektligji për aktet juridike parasheh bazën ligjore për harmonizimin e versioneve të ndryshme gjuhësore të ligjit dhe korigjimin e gabimeve ekzistuese.

<sup>2</sup> Komisioni Evropian, Legjislacioni në Mjedisin Shumëgjuhësh të BE-së, 2010.

<sup>3</sup> Miratuar nga Qeveria me Vendimin nr.01/104, datë 23 maj 2019.

<sup>4</sup> Projektligji nr. 08/L-107 për Aktet Ligjore, neni 3, paragrafi 1.7, [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperaktetjuridike\\_VFMUqrtvDY.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperaktetjuridike_VFMUqrtvDY.pdf)

<sup>5</sup> Po ashtu, neni 10

Avokati i Popullit gjithashtu vëren se edhe Zyra e Komisionarit për Gjuhët<sup>6</sup> e njëj si problem aktual legjislaionin e përkthyer dobët dhe mospërputhjet domethënëse ndërmjet versioneve të ndryshme gjuhësore të akteve ligjore. Prandaj Zyra e Komisionarit për Gjuhët e hartoi një koncept-dokument për reformën e procedurave të përkthimit brenda Qeverisë drejt legjislaionit të harmonizuar dhe shumëgjuhësh.

Prandaj Avokati i Popullit thekson se parimet e mosdiskriminimit, të ligjshmërisë dhe të barazisë para ligjit janë të një rëndësie thelbësore për një sistem të drejtë juridik. Legjislaioni duhet të jetë i qasshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në të gjitha gjuhët zyrtare, në mënyrë që të sigurohet siguria juridike dhe barazia para ligjit, në kuptimin që të gjithë t'i kuptojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre, prandaj është e nevojshme të sigurohet besueshmëria e legjislaionit shumëgjuhësh në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafin 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*. Në kuptim të nenit 18, paragrafit 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, përgjegjësi e Avokatit të Popullit është: *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla, (...)”*; si dhe të: *“rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; (Neni 18, paragrafi 1.7):*

## REKOMANDON

### Kuvendit të Republikës së Kosovës:

- *Sa më parë të jetë e mundur, ta miratojë Projektligjin nr. 06/L-030 për Aktet Juridike dhe me këtë ta sigurojë bazën ligjore për harmonizimin dhe korrigjimin e gabimeve gjuhësore ose teknike në aktet ligjore në rast të mospërputhjeve ndërmjet gjuhëve zyrtare.*

### Qeverisë së Republikës së Kosovës:

- *T’i ndërmarrë masat e nevojshme me të cilat do të sigurohet harmonizimi i legjislaionit dhe korrigjimi i gabimeve thelbësore, gjuhësore, terminologjike, gramatikore dhe drejtshkrimore, qoftë në versionet gjuhësore ekzistuese të ligjeve, qoftë ato në proces hartimi, me ç’ rast do të arrihet besueshmëria e plotë e versioneve të ndryshme gjuhësore të ligjit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim*

---

<sup>6</sup> Zyra e Komisionarit për Gjuhët është e ngarkuar për monitorimin e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve dhe ka mandat të dizajnojë një zgjidhje politike për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

*për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.*

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

